



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2018

PËR

**PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE FORMULËS SË PRIVATIZIMIT TË KLUBEVE
SPORTIVE**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

Neni 1


Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të përcaktojë formën dhe formulën e privatizimit të klubeve sportive, në pronësi të organeve të qeverisjes qendrore dhe njësisve të vetëqeverisjes vendore.

Neni 2

Objekti

1. Të gjithë klubet sportive në pronësi të organeve të qeverisjes qendrore dhe njësisve të vetëqeverisjes vendore, të cilët nuk janë të organizuar ende në formën e një shoqërie aksionare (sh.a.), brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji duhet të shndërrohen në shoqëri aksionare (sh.a.) në përputhje me ligjin nr. 7926/1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar.
2. Organi shtetëror që ka në përgjegjësi administrimi ose në pronësi klubin sportiv dhe/ose që ka në pronësi pronat, asetet, titujt, markat tregtare dhe emrin e mirë të klubit sportiv, vendos si kontribut në natyrë në kapitalin themeltar të shoqërisë aksionare që do të krijohet, të gjithë pronat dhe asetet e klubit sportiv, me përjashtim të stadiumeve dhe sipërfaqeve/ambjenteve të tyre funksionale. Vlera e këtyre pasurive do të llogaritet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
3. Vendimi për privatizimin e klubit sportiv merret nga:



- a) Ministria përgjegjëse për ekonominë, nëse organi që ushtron të drejtat e pronarit të klubit sportiv është një institucion shtetëror qendror, pas miratimit nga organi shtetëror që ka në përgjegjësi administrimi ose në pronësi klubin sportiv.
 - b) Organi që ushtron të drejtat e pronarit të klubit sportiv, sipas ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nëse organi që ushtron të drejtat e pronarit të klubit sportiv është një njësi e vetëqeverisjes vendore.
4. Privatizimi i klubeve sportive realizohet nëpërmjet transferimit të subjektet e interesuar të aksioneve të zotëruara nga organet e pushtetit qendror dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore në këto klube sportive, sipas formulës së privatizimit të parashikuar në këtë ligj.

Neni 3

Forma dhe formula

Forma dhe formula e privatizimit të aksioneve të klubeve sportive, janë si më poshtë:

1. Nga 51 për qind deri në 100 për qind të aksioneve të kapitalit u ofrohen subjekteve të interesuar, të cilët mund të jenë shoqëri apo bashkim shoqërish, që zotërojnë garanci të nevojshme financiare. Paketa e aksioneve të parashikuara në paragrafin e mësipërm transferohet nëpërmjet shitjes, me procedurë konkurruese. Sasia e aksioneve që privatizohet përcaktohet me vendim të organit shtetëror që ka në pronësi klubin sportiv apo të njësisë së vetëqeverisjes vendore që ka në pronësi klubin sportiv.
2. Subjekti që ka financuar ndër vite klubin sportiv dhe rezulton fitues në procedurën e privatizimit, përfiton zbritje nga çmimi final i privatizimit në masën e financimeve që nuk u janë njohur si shpenzime të zbritshme për efekt të tatimeve të paguara, sipas kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për përlllogaritjen e shpenzimeve të zbritshëm përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Kriteret e vlerësimit të aksioneve që do të privatizohen, të përzgjedhjes së subjekteve të interesuara, vlerësimit të ofertave, si dhe procedura e privatizimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe bazohen në këta elementë :
 - a) Deri në 60 për qind e pikëve të kriterëve të vlerësimit për shpalljen fitues, i caktohen:
 - i. Investimit të subjektit të interesuar në klubin sportiv ose kontributit të drejtpërdrejtë në klubin sportiv nëpërmjet financimit të parave *cash*;
 - ii. Eksperiencës së mëparshme në financime, përfshirje apo administrim të klubeve sportive;
 - iii. Kriteret e tjera.
 - b) Deri në 40 për qind të pikëve të kriterëve të vlerësimit për shpalljen fitues, i caktohen çmimit të ofruar për aksion.

Neni 4

Mos ndryshimi i destinacionit të objekteve sportive

1. Destinacioni i objekteve sportive, në kuptim të ligjit nr. 79/2017, datë 27.04.2017 “Për sportin”, të cilat janë në pronësi të klubeve sportive, nuk mund të ndryshohet pavarësisht privatizimit, për të paktën 99 vjet.
2. Për efekt të pikës 1 më sipër, kontrata për shitjen e aksioneve duhet të përmbajë:

- a) detyrimin që subjekti i interesuar të mos ndryshojë destinacionin e objekteve sportive;
 - b) detyrimin e palëve për të regjistruar në regjistrat e zyrës vendore të pasurive të paluajtshme këtë kufizim të së drejtës së pronësisë;
 - c) parashikimin së në rast tjetërsimi të objektit sportiv, pronari i ri mbart të njëjtin kufizim të së drejtës së pronësisë.
3. Në rastin kur subjekti i interesuar do të shembë dhe do të rindërtojë nga fillimi një objekt sportiv në pronësi të klubit sportiv të privatizuar, mbi objektin e ri sportiv të ndërtuar do të aplikohen të njëjtat ndalesa për mos ndryshimin e destinacionit, sipas pikës 2 të këtij neni.
4. Destinacioni i objekteve sportive të cilat janë në pronësi të klubeve sportive, nuk mund të ndryshohet as në rast falimenti.

Neni 5

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për miratimin e akteve nënligjore në zbatim të pikave 2 dhe 3 të nenit 3, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

GRAMOZ RUÇI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
MINISTRI

Nr. Prot. Tiranë _____ 2018

Nr. Prot. Tiranë _____ 2018

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR

PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE FORMULËS SË PRIVATIZIMIT TË KLUBEVE SPORTIVE”

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është përcaktimi i formës dhe formulës së privatizimit të klubeve sportive, në pronësi të organeve të qeverisjes qendrore dhe njësisive të vetëqeverisjes vendore.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është në përputhje të plotë me programin politik të Këshillit të Ministrave.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Relacion shpjegues për projektligjin “Për përcaktimin e formës dhe formulës së privatizimit të klubeve sportive”

Rreth një vit më parë është miratuar ligji i ri që rregullon çështjet e sportit në Republikën e Shqipërisë. Ligji nr. 79/2017 “Për Sportin” është hartuar duke marrë në konsideratë legjislacionin e sportit në vendet e Bashkimit Evropian si dhe rekomandimet përkatëse të organizmave të tij. Ligji ka si qëllim, ndër të tjera, përcaktimin e kompetencave të autoriteteve qendrore dhe vendore në fushën e sporteve, përcaktimin e bazave të përgjithshme dhe ligjore të organizimit e të zhvillimit të sportit, si dhe të shërbejë si mbështetje ligjore, financiare dhe organizative për funksionimin e institucioneve dhe të organizatave sportive, publike e private. Bazuar në këtë ligj, sporti është një veprimtari publike. Shteti nxit zhvillimin e sportit në të gjithë nivelet, duke mbështetur pjesëmarrjen e shtetasve në sport, nëpërmjet krijimit të kushteve ligjore, financiare dhe të infrastrukturës sportive.

Megjithëse ligji i përgjigjet kërkesave të kohës për rregullimin dhe normimin e marrëdhënieve juridiko-civile midis aktorëve, në fushën e sportit, situata e sportit në përgjithësi dhe gjendja e infrastrukturës sportive në vend, janë ende shumë larg pritshmërisë së sportistëve amatorë, sportistëve profesionistë, si dhe publikut të gjerë. Kjo situatë, kërkon investime dhe financime të mëdha dhe Buxheti i Shtetit është i kufizuar në raport me nevojat.

Në përgjigje të shqetësimeve dhe problematikave të evidentuara është parë e nevojshme të analizohet kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi lidhur me privatizimin e klubeve dhe objekteve sportive, pronë shtetërore duke u rënë dakord për miratimin e një ligji të ri që do të rregullojë këtë situatë.

Nëpërmjet këtij projektligji synohet të përcaktohet një formë dhe formulë privatizimi për klubet sportive. Duke marrë parasysh mungesën e interesit komercial për investime private në sport, projektligji mban në konsideratë tre elementë thelbësorë: (a) pesha kryesore në formulën e privatizimit i jepet planit të investimit dhe kontributeve të drejtpërdrejta për operimin e klubit sportiv (Deri në 10 për qind të pikëve të kritereve të vlerësimit për shpalljen fitues, i caktohen çmimit të ofruar për aksion), (b) në mënyrë që të ruhet përcaktimi i ligjit për sportin, sipas të cilit destinacioni i objekteve sportive nuk duhet të ndryshohet, pavarësisht privatizimit, për të paktën 99 vjet dhe (c) Subjekti që ka financuar ndër vite klubin sportiv dhe rezulton fitues në procedurën e privatizimit, përfiton zbritje nga çmimi final i privatizimit në masën e financimeve që nuk u janë njohur si shpenzime të zbritshëm për efekt të tatimeve të paguara, sipas kritereve, procedurave dhe dokumentacionit për përlllogaritjen e shpenzimeve të zbritshëm përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Ky projektligj ka si efekt të pritshëm shndërrimin e klubeve sportive në pronësi të organeve të qeverisjes qendrore dhe njësisive të vetëqeverisjes vendore, në shoqëri aksionare (sh.a.) brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga hyrja në fuqi e

këtij ligji, në përputhje me ligjin nr. 7926/1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar.

Organi shtetëror që ka në përgjegjësi administrimi ose në pronësi klubin sportiv dhe/ose që ka në pronësi pronat, asetet, titujt, markat tregtare dhe emrin e mirë të klubit sportiv, vendos si kontribut në natyrë në kapitalin themeltar të shoqërisë aksionare që do të krijohet, të gjithë pronat dhe asetet e klubit sportiv. Vlera e këtyre pasurive do të llogaritet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Vendimi për privatizimin e klubit sportiv merret nga:

- a) Ministria përgjegjëse për ekonominë, nëse organi që ushtron të drejtat e pronarit të klubit sportiv është një institucion shtetëror qendror, pas miratimit nga organi shtetëror që ka në përgjegjësi administrimi ose në pronësi klubin sportive.
- b) Organi që ushtron të drejtat e pronarit të klubit sportiv, sipas ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nëse organi që ushtron të drejtat e pronarit të klubit sportiv është një njësi e vetëqeverisjes vendore.

Privatizimi i klubeve sportive realizohet nëpërmjet transferimit të subjektet e interesuar të aksioneve të zotëruara nga organet e pushtetit qendror dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore në këto klube sportive, sipas formulës së privatizimit të parashikuar në këtë ligj.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është hartuar në zbatim të neneve 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk lidhet me çështjet e përafrimit të legjislacionit me *acquis communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në **nenin 1** të projektligjit parashikohet se qëllimi i këtij ligji është të përcaktojë formën dhe formulën e privatizimit të klubeve sportive, në pronësi të organeve të qeverisjes qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore.

Në **nenin 2** të projektligjit parashikohet se të gjithë klubet sportive në pronësi të organeve të qeverisjes qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, të cilët nuk janë të organizuar ende në formën e një shoqërie aksionare (sh.a.), brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji duhet të shndërrohen në shoqëri aksionare (sh.a.) në përputhje me ligjin nr. 7926/1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar.

Organi shtetëror që ka në përgjegjësi administrimi ose në pronësi pronat, asetet, titujt, markat tregtare dhe emrin e mirë të klubit sportiv, vendos si kontribut në natyrë në kapitalin themeltar të shoqërisë aksionare që do të krijohet, të gjithë pronat dhe asetet e klubit sportiv. Vlera e këtyre pasurive do të llogaritet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Vendimi për privatizimin e klubit sportiv merret nga:

- a) Ministria përgjegjëse për ekonominë, nëse organi që ushtron të drejtat e pronarit të klubit sportiv është një institucion shtetëror qendror, pas miratimit nga organi shtetëror që ka në përgjegjësi administrimi ose në pronësi klubin sportive.
- b) Organi që ushtron të drejtat e pronarit të klubit sportiv, sipas ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nëse organi që ushtron të drejtat e pronarit të klubit sportiv është një njësi e vetëqeverisjes vendore.

Privatizimi i klubeve sportive realizohet nëpërmjet transferimit të subjektet e interesuar të aksioneve të zotëruara nga organet e pushtetit qendror dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore në këto klube sportive, sipas formulës së privatizimit të parashikuar në këtë ligj.

Në **nenin 3** të projektligjit parashikohet se forma dhe formula e privatizimit të aksioneve të klubeve sportive, janë si më poshtë:

1. Nga 51 për qind deri në 100 për qind të aksioneve të kapitalit u ofrohen subjekteve të interesuar, të cilët mund të jenë shoqëri apo bashkim shoqërisht, që zotërojnë garanci të nevojshme financiare. Paketa e aksioneve të parashikuara në

paragrafin e mësipërm transferohet nëpërmjet shitjes, me procedurë konkurruese. Sasia e aksioneve që privatizohet përcaktohet me vendim të organit shtetëror që ka në pronësi klubin sportiv apo të njësisë së vetëqeverisjes vendore që ka në pronësi klubin sportiv.

2. Subjekti që ka financuar ndër vite klubin sportiv dhe rezulton fitues në procedurën e privatizimit përfiton zbritje nga çmimi final i privatizimit në masën e financimeve që nuk u janë njohur si shpenzime të zbritshëm për efekt të tatimeve të paguara.

3. Kriteret e vlerësimit të aksioneve që do të privatizohen, të përzgjedhjes së subjekteve të interesuara, vlerësimit të ofertave, si dhe procedura e privatizimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe bazohen në këta elementë:

a) Deri në 60 për qind e pikëve të kriterëve të vlerësimit për shpalljen fitues, i caktohen:

- i. Investimit të subjektit të interesuar në klubin sportiv ose kontributit të drejtpërdrejtë në klubin sportiv nëpërmjet financimit të parave *cash*;
- ii. Eksperiencës së mëparshme në financime, përfshirje apo administrim të klubeve sportive;
- iii. Kriteret e tjera.

b) Deri në 40 për qind të pikëve të kriterëve të vlerësimit për shpalljen fitues, i caktohen çmimit të ofruar për aksion.

Në nenin 4 të projektligjit parashikohet se:

Destinacioni i objekteve sportive, në kuptim të ligjit nr. 79/2017 "Për sportin", të cilat janë në pronësi të klubeve sportive, nuk mund të ndryshohet pavarësisht privatizimit, për të paktën 99 vjet.

Kontrata për shitjen e aksioneve duhet të përmbajë:

- a) detyrimin që subjekti i interesuar të mos ndryshojë destinacionin e objekteve sportive;
- b) detyrimin e palëve për të regjistruar në regjistrat e zyrës vendore të pasurive të paluajtshme këtë kufizim të së drejtës së pronësisë;
- c) parashikimin së në rast tjetërsimi të objektit sportiv, pronari i ri mbart të njëjtin kufizim të së drejtës së pronësisë.

Në rastin kur subjekti i interesuar do të shembë dhe do të rindërtojë nga fillimi një objekt sportiv në pronësi të klubit sportiv të privatizuar, mbi objektin e ri

sportiv të ndërtuar do të aplikohen të njëjtat ndalesa për mos ndryshimin e destinacionit, si më lart.

Destinacioni i objekteve sportive të cilat janë në pronësi të klubeve sportive, nuk mund të ndryshohet as në rast falimenti.

Në nenin 5 të projektligjit parashikohen miratimi i akteve nënligjore nga Këshilli i Ministrave, në zbatim të pikave 2 dhe 3 të nenit 3, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Për hartimin e këtij projektligji ka kontribuar grupi i ndërinstitucional i punës.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji nuk shoqërohet me efekte financiare për buxhetin e shtetit.

Koli
Bele

Digitally signed
by Koli Bele
Date: 2018.09.21
14:34:53 +0200

PROPOZUESI

MINISTËR

ARBEN AHMETAJ

PROPOZUESI

MINISTËR

LINDITA NIKOLLA

Lindita
Nikolla

Digitally signed
by Lindita Nikolla
Date: 2018.09.21
16:46:33 +02'00'